



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skuptina Opštine Dragaš/Dragas Municipality
- Kuvendi Komunal
01 Nr.020-711/1
Dt.23.11.2010
D r a g a s h

Kuvendi Komunal i Dragashit, pas shqyrtimit paraprak të Përgjigjes së MAPL-it III Nr.02-555/1 të dt.19.08.2010 në Ankesë të Degës së AAK-së Dragash lidhur me Vendimet 01 Nr.06/068/1-2 të dt.12.07.2010 të KK-së Dragash reth përbërjes së KPFinanca të KK-së Dragash, pas shqyrtimit paraprak në mbledhjen e komiteteve të KK-së më dt.18.11.2010, si dhe në seancën e Kuvendit Komunal të dt.23.11.2010, miratohet ky:

V E N D I M

- I. **VERIFIKOHEN** vendimet e mëparshme të Kuvendit Komunal të Dragashit i dt.12.07.2010 lidhur me themelimin e komiteteve të KK-së Dragash.
- II. Kuvendi këtë Vendim e morri pas shqyrtimit paraprak dhe votimit të aplikuar me shumicë votash, në favor të Vendimit të mëparshëm të Kuvendit 01 Nr.06-068/1 të dt.12.07.2010, me rezultat 15 “pro”, 9 “kundër” dhe 1 “abstenim”.
- III. Komitetet obligative të KK-së Dragash (Komiteti për Politikë e Financa dhe Komiteti për Komunitete) edhe në të ardhmen të veprojnë konform vendimeve 01 Nr.06-068/1-2 të dt.12.07.2010.

A r s y e t i m

Vendimet zyrtare për themelimin e komiteteve të lartpërmendura obligative të KK-së Dragash janë marr në seancën e Kuvendit të dt. 12.7.2010 dhe ,aktualisht, konsiderohet se përfaqësojnë strukturën e subjekteve politike, duke u aplikuar procedura e votimit me shumicë votash, siç është aplikuar edhe në seancën e dt.23.11.201, me konstatim se nuk kishte shkelje procedurale-ligjore. Konkretisht, sipas Vendimit të verifikuar, KPFinanca është paraparë dhe vendosur që të ketë 7 anëtarë (2 PDK, 2 LDK dhe 1 “Vakat” dhe 1 subjektet tjera politike-përfshi edhe AAK-në (që kanë deleguar një pozitë për LDD-në). Sipas kësaj strukture partiake dhe në bazë të LV Lokale, vetvetiu, kryetar dhe anëtar i KPFinanca është kryesuesi i KK-së i cili, po ashtu , është nga radhët

e PDK-së.Pra,më 12.07.2010,në KPFinanca 7-anëtarësh,LDK-ja , nuk ka qenë e gatshme të delegon 2 anëtarët e paraparë për te, në shenjë mospajtimi me numrin e anëtarëve dhe,me gjasë,mospajtimeve të brendshme të tyre dhe tani KPFinanca,ende,funksionon me 5 anëtarë.

Ndërkaq,lidhur me shqyrtimin e Përgjigjes së apostrofuat të MAPL-it,vlen të theksohet se, edhe në seancën e Kuvendit të dt.23.11.2010, ka qenë prezente gatishmeria e Kuvendit që, KPFinanca të zgjerohet dhe të përfaqësohet edhe AAK-ja me një delegat(nga gjinia femërore-për shkak të ruajtjes së strukturës gjinore),por që nuk u përkrahë nga 2 delegatët e AAK-së dhe u vendos si në pikën I të këtij Vendimi.

Shtojcë : Shkresa-Përgjigjja(ankesë) e MAPL-it) dhe vendimr KK-së për themelimin e të KPFinanca dhe Kkomuniteteve të KK-së Dragash

I dërgohet :

- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal-Prishtinë z.Besnik Osmani
- Degës së AAK-së Dragash,kryetarit Burim Piraj, dhe
- Arkivit



KUVENDI KOMUNAL-DRAGASH

Kryetari
Lulzim Rifaj